



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi:051

DHUNA NDAJ BASHKËMOSHATARËVE

Parandalimi dhe ndërmjetësimi

Objektivat e programit:

Me përvetësimin e këtij programi, pjesëmarrësit do të jenë të aftë

- Të demonstrojnë aftësi për shpjegimin e koncepteve që lidhen me dhunën
- Të identifikojnë shkaqet e dhunës ndaj bashkëmoshatarëve në shkolla
- Të intervenojnë ndaj akteve dhe veprimeve të dhunshme ndaj bashkëmoshatarëve në shkollë
- Të tregojnë gatishmëri për denoncimin e dhunës ndaj bashkëmoshatarëve në shkollë
- Të tregojnë aftësi për përdorimin e metodave të kompensimit në raste dhune

Përmbajtja:

Koncepti dhe natyra e dhunës. Llojet e dhunës (dhuna verbale, emocionale-psikologjike, fizike, ekonomike, seksuale). Kriteret për klasifikimin e dhunës. Shkaqet e dhunës. Denoncimi i dhunës. Intervenimi ndaj dhunës. Viktimat e dhunës. Ushtruesit e dhunës. Pasojat e dhunës. Metodatat e kompensimit të dëmeve të dhunës - restitucioni. Karakteristikat e ushtruesve të dhunës. Mjetet për parandalimin e dhunës (Hulumtime, sondazhe, planifikime strategjike, evokime, këshillime).

Grupi i synuar:

Ky program i dedikohet punëtorëve të arsimit, si dhe të gjithë atyre që tregojnë interesim për të zotëruar teknikat për parandalimin e dhunës ndaj bashkëmoshatarëve.

Forma e organizimit/Kohëzgjatja:

Programi organizohet në formë të një seminari 4 ditor dhe ka gjithsej **32 orë**.
Certifikimi:

Kusht për certifikim është pjesëmarrja prej të paktën 80% në seminar. Njëherit certifikimi për pjesëmarrje nënkupton që pjesëmarrësit të cilët kanë përfunduar kursin për dhunën ndaj bashkëmoshatarëve, të demonstrojnë njohuri për parimet, proceset, përmbajtjen dhe metodologjinë për identifikimin dhe intervenimin në rastet ndaj dhunës në mes të bashkëmoshatarëve. Demonstrimi i dijeve dhe shkathtësive për intervenim dëshmohet nëpërmjet kontributeve – aktiviteteve të pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit që përmbushin këto kritere marrin “ Certifikatën për pjesëmarrje”